



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS**  
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE**

Durrës, më 25.04.2024

**PROCESVERBAL**  
**Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE**  
**KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me datë 25.04.2024 në Durrës, nga ana e Njesisë së Prokurimit, ngritur me urdhrin nr.2878/1 prot., datë 23.04.2024, me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit ‘E Hapur e Thjeshtuar’, me të dhënat si më poshtë vijon:

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Vendosje Monitor LED në Bashkinë Durrës”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):** Kodi (CPV) 30231300-0 - Ekrane vizualizimi.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 2.407.700 (dy milion e katërqind e shtatë mijë e shtatëqind) Lek pa TVSH.

**Argumentim:**

**MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS**  
**LIMIT TË KONTRATËS**

“Në zbatim të urdhërit të grupit të punës nr. 57, datë 28.02.2024 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, “Për hartimin e specifikimeve teknike si dhe përlllogaritjen e fondit Limit për procedurën e prokurimit me objektin e mësipërm”, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2023-2024 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Dokumentat lidhur me preventivin dhe specifikimet teknike të punimeve, të hartuar nga grupi i punës në Bashkinë Durrës.

## **1. PËRCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

Në përcaktimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në:

Specifikimet teknike të hartuar nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës, objekt i këtij prokurimi.

*Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” i ndyshuar.*

## **2. PËRLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TE KONTRATËS**

**2.1 Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Mbështetur në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”; VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, rekomandimit të APP-së nr 3872 prot, datë 10.06.2021 “Mbi hartimin e procesverbalit (Tipi i kontratës-Mall) të argumentimit dhe miratimit të specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”,**

Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë vijon: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

- a) çmimet e tregut; ose/dhe
- b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe çmimet ndërkombëtare, të botuara.

**Komisioni organizoi punën** për kërkimin dhe grumbullimin e informacionit mbi çmimet orientuese në treg për të gjithë elementët e kostos së mallrave objekt i këtij prokurimi.

Në përfundim të kërkimeve, u vërejt se:

1. Grupi i punës verifikoi në faqet zyrtare të ISTAT dhe manualeve të çmimeve ku konstatoi se për këtë prokurim nuk ka çmime.
2. Grupi i punës u bazua në analizat e hartuar nga vetë grupi por duke studiuar tregun vendas.

Afati i realizimit të punimeve është 28 dite, sipas grafikut te punimeve.

Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ndyshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Sipas specifikimeve bashkangjitur të hartuar, vendosur dhe perlloritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlloritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndyshuar.

## **1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit , sipas Shtojcës 8;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, i ndryshuar, nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,

2022, ku vlera e xhiros vjetore nga data e zhvillimit të tenderit të jetë deri në 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 e 55 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

---

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te

miratuar”, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të neneve 43, pika 4, 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023 referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë deri në 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

*Referuar fondit limit sipas nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*

---

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NS-13A** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- **NS-14A** Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
<b>NS-13A</b>	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. F.V Ekran LED Wall me pixel P1,5</li> <li>2. F.V Procesor profesional per kontrollin e Ekranit</li> <li>3. F.V Kamera PTZ per Video Konference</li> <li>4. F.V Speakerphone per konferenca</li> <li>5. F.V Mikrofona shtese per sistemin e Konferences</li> <li>6. F.V Mixer Audio 8 kanale me efekte</li> <li>7. F.V Amplifikator Profesional Audio</li> <li>8. F.V Bokse Audio Mural</li> <li>9. F.V Mikrofon Wireless Akullore</li> </ol>	A, 0-20 milionë lekë	<b>A.</b>  Tot. <b>2,170,000 lek</b>
<b>NS-14A</b>	1.Ndertim per n/stacion kabina e transformatore, linja të tn, të mesëm dhe shpërndarja e energjisë	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. F.V Kutu Automati JM</li> <li>2. F.V Automat 3F 63A</li> <li>3. F.V Kabull elektrik 4x6mm</li> <li>4. F.V Bazament per montimin e ekranit</li> <li>5. F.V Kabull HDMI me Fiber Optike 10m</li> <li>6. F.V Kabull Boksesh 2*1,5</li> <li>7. F.V Rack 12U</li> </ol>	A, 0-20 milionë lekë	<b>A.</b>  Tot. <b>237,700 lek</b>

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

**a.** Inxhinier Informatik / Elektronik 1 (një)

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: diploma e inxhinierëve dhe kontrata pune.*

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. 1 punonjës të certifikuar si Specialist ne Teknologjinë e Mbrojtjes së rrjetit dhe Aplikacioneve.
- b. 1 punonjës të certifikuar për Sistemet Audio-Video konferencave.
- c. 1 elektrikist për punimet elektrike.
- d. 1 punonjës të certifikuar për Instalimin e Konfigurimin e ekraneve Led Wall.

*Për stafin e sipërcituar të disponojë dokumentacion që vërteton profesionin si: dëshmi profesionale të punonjësve ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune.*

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, konkretisht:

**Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**

- Inxhinieri Informatik / Elektronik është i nevojshëm për inspektimin e punimeve dhe konfigurimet e sistemit.
- 1 punonjës të certifikuar si Specialist ne Teknologjine e Mbrojtjes se rrjetit dhe Aplikacioneve.
- 1 punonjës të certifikuar per Sistemet Audio-Video konferencave .
- 1 elektrikist për punimet elektrike
- 1 punonjës të certifikuar për Instalimin e Konfigurimin e ekraneve Led Wall.



**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 5 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

*Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

**Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve të punës dhe grafikut të punimeve.**

Referuar VKM nr.629, datë.15.07.2015, “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”, është bërë përlllogaritja teknike e mjeteve/ makinerive/ pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: Shtojcat që janë për t’u plotësuar nga Kandidati/Ofertuesi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të

lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë...

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhtme:

### 1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor:

Emri Bashkia Durrës  
Adresa Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës  
Tel/Faks 052 22 23 10  
E-mail [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)



Ueb-faqe [www.durres.gov.al](http://www.durres.gov.al)

- 2. Lloji i procedurës së prokurimit:** Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Mall.
- 3. Numri i referencës së procedurës /Lotit:** REF-02673-04-25-2024
- 4. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** “Vendosje Monitor LED në Bashkinë Durrës”
- 5. Fondi limit:** 2.407.700 (dy milion e katërqind e shtatë mijë e shtatëqind) Lek pa TVSH.
- 6. Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 28 ditë
- 7. Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:** 07.05.2024 Ora: 10:00

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër, firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit. Pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP-së ([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

### Njësia e Prokurimit

